



Npi – 01/38 datë: 05.03.2026

Duke u bazuar në nenin 5 shkronja (c) nenin 12.2 shkronja (d) nenin, 17 shkronja (f) si dhe nenin 25 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 5.2 dhe 8.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087; Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike; Ligjin Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më: 05.03.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NDËRRMARRJEN PUBLIKE LOKALE “EKOSISTEMI” SH.A. - SHTIME

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -I- të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 05.03.2026, me shumicën e votave miratoi, vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ekosistemi” SH.A. - Shtime.

II

Përbërja e Komisionit të Aksionarëve, është si vijon:

1. z.Fadil Ismajli (i emëruar nga Kryetari i Komunës),
2. z.Atdhe Isufi (i zgjedhur nga Kuvendi),
3. z.Bajram Hajrizi (i zgjedhur nga Kuvendi).

III

- 4.1 Komisioni i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.
- 4.2 Komisioni i Aksionarëve i raporton Kuvendit të Komunës në bazë vjetore.
- 4.3 Mandati i anëtarëve të Komisionit të Aksionarëve zgjatë aq sa zgjatë mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Shtimes.
- 4.4 Kuvendi i Komunës së Shtimes e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të Komisionit kur do herë që kërkohet.

IV

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komisionit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Drejtorive, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi